

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE STATUTI I SHOQËRISË  
“ELIXIRIS” SHPK**

**THEMELIMI**

Neni 1  
Ortaku themelues

1.1 Shoqëria “ELIXIRIS” SH.P.K. themelohet nga Ortaku:  
Z. Alessandro Grasso, shtetas italian, lindur më 15.07.1980 ne Castelvetrano (TP), Itali,  
rezident Via Sofia TF, nr.SNC Frazione Tre Fontane, Komuna e Campobello di  
Mazara, (TP), Cap.91021, Itali mbajtes i Pasaportes me Nr. YB7377416 me zotesi te plete per  
te vepruar;

**EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

Neni 2  
Emërtimi

2.1 Emërtimi i shoqërisë është “ELIXIRIS” SH.P.K.

Neni 3  
Forma ligjore

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje  
me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin  
shqiptar.

Neni 4  
Baza ligjore

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e  
Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5  
Kohëzgjatja e veprimtarisë

5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit  
(“QKB”).

5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

Neni 6  
Selia

6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Besim Alla, Pallati Alfa, Hyrja 4, Zyra nr.14,  
Njesia Administrative nr.14, Tirane.

6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësimi si brenda territorit të  
Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të  
krijohen në të ardhmen.

Neni 7  
Emblema. Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjisacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përbajnë emblemën dhe vulën e saj.

Neni 8  
Objekti

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:
- Aktivitet ne fushen e ristoracionit.
  - Tregtim i produkteve italiane ne tregun shqiptar.
  - Konsulencë dhe kerkim mbi teknologjite e reja te prodhimit ushqimor. Kerkim dhe prodhim ne kulturat e reja bujqesore.
- Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 9  
Kapitali

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 ALL (Njeqind mijë ALL).
- 9.2 Kapitali ndahet në 1 (nje) pjesë.
- 9.3 Pjesa e kapitalit zotërohet 100% nga Ortaku i vetem.
- 9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

- 10.1 Kuotat e kapitalit mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
- 10.2 Pjesët e kapitalit mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.
- 10.3 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlgimin e Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 11  
Rritja e kapitalit

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 12  
Zvogëlimi i kapitalit

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjisacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpëra marrjes së vendimit nga Asambleja e Ortakut te vetem te shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese se Ortakut te vetem raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem të shoqërisë.

## ORGANET E SHOQËRISË

### Neni 13

Vendimet e ortakut të vetëm

13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren prej Asamblese se Ortakut te vetem.

13.2 Vendimet e Asamblese se Ortakut te vetem përfshijnë kryesisht:

- Ndryshimin e selisë ose të emërtimit të shoqërisë;
- Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
- Prishjen dhe likujdimin e shoqërisë;
- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë;
- Transformimin e shoqërisë në formë të tjera.
- Vendimarrjen per investime te reja ne fushen e pasurive te paluajtshme brenda apo jashte territorit shqiptar.

### Neni 14

Administrimi

14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakut të Vetëm.

14.3 Administratori i shoqërisë eshte Z. Alessandro Grasso, shtetas italian, lindur më 15.07.1980 ne Castelvetrano (TP), Itali, rezident Via Sofia TF, nr.SNC Frazione Tre Fontane, Komuna e Campobello di Mazara, (TP), Cap.91021, Itali mbajtes i Pasaportes me Nr.YB7377416 me zotesi te plote per te vepruar;

14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:

- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
  - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
  - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
  - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
  - Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.
  - Administratori ka të drejtë për ta përfaqësuar shoqërinë në Shqipëri apo kudo jashte saj tek palët e treta, insitucionë apo entitete publike ose private,
  - Të lidhë, për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
  - Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm përmbarëvajtjen e biznesit;
  - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpëra bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar,
  - Të hape dege ose zyre perfaqësimi, qe konsiderohen te nevojshëm përbiznesin e shoqërisë.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm përsë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 15  
Viti financiar

15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.

15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16  
Bilanci. Kontabiliteti.

16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i vetem dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblese se Ortakut te vetem.

Neni 17  
Te Ardhurat. Dividendi

17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport më pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.

17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të pergjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18  
Likujdimi

18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblese se Ortakut te vetem.

18.2 Me vendimin e Asamblese se Ortakut te vetem caktohet një likujdator ose një grup likujdatorësh që do të plotësojnë procedurat e likujdimit.

18.3 Likujdatori do të përgatisë raportin e likujdimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likujdimit dhe kohën që nevojitet përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedurë, Asambleja e Ortakut te vetem do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likujdimit.

Neni 19  
Mosmarrëveshjet

19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Tiranë, datë 09.11.2021

ORTAKU:

Z. Alessandro Grasso

